

# KAPITALIZIMI

Ura që lidh të shkuarën me të ardhmen



## Çfarë është kapitalizimi?

Kapitalizimi është procesi i kthimit të përvojës dhe njohurive në vlera afatgjata.

Gjatë kapitalizimit nxirren mësim nga përvoja dhe ndahen me të gjithë aktorët e përfshirë për të dalë në një analizë të hollësishme të sukseseve dhe sfidave drejt qëllimeve të përbashkëta.

### Në kontekstin e HAP, kapitalizimi ka për qëllim:

- Të ruajë dhe forcojë rezultatet e projektit
- Të nxjerrë mësim dhe praktika të mira nga përvoja shumëvjeçare
- Ta transferojë këtë "kapital njohurish" tek institucionet vendase për të udhëhequr strategjitë e ardhshme.

### Pse ka rëndësi kapitalizimi?

- 📄 **Ruajmë dijen** – mësimet dhe sukseset nuk humbasin kur projekti mbyllet.
- 👨 **Forcojmë kujdesin shëndetësor** – ekipet e mjekësisë familjare bashkëpunojnë më mirë dhe rriten profesionalisht.
- 🏛️ **Ndihmojmë politikëbërësit** – vendimet bazohen në evidenca dhe përvoja konkrete.
- 🔒 **Sigurojmë qëndrueshmëri** – ndryshimet e sjella mbeten dhe zhvillohen në kohë.
- 👉 **Krijojmë pronësi lokale** – institucionet dhe profesionistët shqiptarë bëhen mbajtësit dhe mbështetësit e vazhdimësisë së risive të projektit.

### Kush merr pjesë në procesin e kapitalizimit?

- Punonjës të kujdesit shëndetësor parësor
- NJVKSH-të dhe Operatori Rajonal/Qendror
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Fondi i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor
- OJF-të dhe pacientët
- Ekspertë që lehtësojnë tryezat e diskutimit dhe përpunojnë të dhënat e mbledhura

### Si ndodh kapitalizimi?

1. **Mblidhen përvojat**: dëshmitë, sukseset, sfidat, pengesat.
2. **Diskutohen së bashku** në panele, tryeza të rrumbullakta, etj.
3. **Krijohen produkte** të dobishme si raporte, studime rasti, etj.
4. **Shpërndahet dija** me profesionistë, autoritete dhe institucione.
5. **Integrohet në politika** me qëllim që praktikat më të mira të bëhen standard kombëtar.

### Çfarë fitojmë nga kapitalizimi?

- 🌟 **Ruajtje dhe shtrirje të mëtejshme të shërbimeve/praktikave që funksionojnë** – si Kujdesi në Banesë dhe Grupet e Kolegëve, që mbeten si modele reference edhe pas përfundimit të projektit.
- 🏛️ **Përmirësim të praktikave** – mësimet e nxjerra ndihmojnë për të korrigjuar dhe forcuar sistemin.
- 🎯 **Udhëzime të qarta për të ardhmen** – politika, strategji dhe plane konkrete që mbështeten në evidenca.